

keqtrajtimet fizike dhe me plagët në qafë dhe në fytyrë. Beqiri ka thënë se e kishte rrahur vet shefi i stacionit policor, Vukmir Mirčić, duke e detyruar të tregonte nga kush e ka marr pushkën, e cila ishte gjetur në shtëpinë e komshiut të Beqirit. Ditën tjetër, më 31.05.1998, Beqirin sërish e kanë marrë në pyetje. Kur e kthyen, ishte në gjendje gjysmë të vetëdijshme dhe kishte gjakderdhje nga një vesh, por arriti t'i rrëfente Sylës se shefi i policisë e shqelmonte me këmbë në fytyrë, sepse nuk pranonte që përpara kamerës t'i ngarkonte disa njerëz. Policia e ka liruar Beqirin më 3.06.1998, vetëm një ditë pas liritimit të Sylës, Cymës dhe të tjerëve. Policët e kanë çuar Beqirin te Sylja, ku ishin Cymja dhe të tjerët. Beqiri ishte në gjendje shumë të rëndë. Doktor Mirko Pešić pati ardhur dy herë për t'i dhënë infuzion. Ka thënë se Beqiri duhej të shkonte të shtrihet në spital, por ai vetë nuk guxonte ta çonte atje, sepse për një gjë të tillë nuk e kishte aprovimin e shefit të policisë. Nga pasojat e torturimit, Beqiri ndërroi jetë më 7.06.1998. Po atë ditë, e varrosën në oborin e Sylës. Në vitin 1999, familja i ka rivarrosur mbetjet mortore të Beqirit në varrezat e Deçanit/Deçane.

Burimet: deklarata S.C, FDH-17040; deklarata X.C, FDH-12105; deklarata H.N, FDH-12103; deklarata C.C, FDH-12087; deklarata NN, FDH-12085; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Idriz (Bekë) Qorraj

(1948, shqiptar nga Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçane, bujk, pesë fëmijë)

Në fund të muajit maj të vitit 1998, familjet e Idrizit dhe të vëllait Zymerit e kanë braktisur fshatin **Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg** për shkaqe sigurie. Shkuan në Isnjiq/Istinić. Por Idrizi nuk deshi të lëvizte nga shtëpia e vet. Pas dy muajsh, kur Zymeri u kthye në fshat, i vëllai nuk gjendej më në shtëpi. Një mik nga Deçani/Deçane i ka thënë Zymerit se policia e kishte marr Idrizin dy herë në pyetje dhe pastaj e lëshonte në shtëpi. Por, pas marrjes së tretë në pyetje nga policia [**qershor 1998**], Idrizi nuk u kthye më në shtëpi. Nga kjo ditë, Idrizit i humbet çdo gjurmë. Për fatin e tij

nuk dihet asgjë as sot. Zhdukja e Idrizit është e evidentuar nga KNKK-ja dhe lënda e tij e mban numrin rendor BLG-803306-01.

Burimet: deklarata H.Z, FDH-17891; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Gale (Hysen Nishiçi) Loshaj

(1909, shqiptare nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, një fëmijë)

Gale Loshaj ka mbetur në shtëpi [**Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg**] pas datës 29.05.1998, kur familja e saj e kishte braktisur fshatin, duke u strehuar në Irzniq/Rznić. I biri dhe e reja i sillnin rregullisht ushqime. Dy javë pas braktisjes së fshatit, i biri kishte dëgjuar se të ëmën e kishin vrarë në shtëpinë e saj [**qershor 1998**]. Pas normalizimit të situatës, në muajin tetor të vitit 1998, i biri dhe e reja u kthyen në fshat dhe e gjeten trupin e Gales në brendi të shtëpisë. Në muret e shtëpisë vëreheshin gjurmët e gjakut. E varrosën plakën në bahçen e saj. Ajo edhe sot prehet në të njëjtin vend.

Burimi: deklarata U.L, FDH-17910.

Igballe (Sali Gashi) Tahiraj

(1959, shqiptare nga Ratishi i Ulët/Donji Ratiš, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, tetë fëmijë)

Sebahate (Brahim) Tahiraj

(shqiptare nga Ratishi i Ulët/Donji Ratiš, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, e pamartuar, pjesëtare e UÇK-së)

Melihate (Brahim) Tahiraj

(1980/1981, shqiptare nga Ratishi i Ulët/Donji Ratiš, komuna e Deçanit/Deçani)

Pas vdekjes së bashkëshortit, Igballja me fëmijë jetonin vetëm në **Ratishin e Ulët/Donji Ratiš**. Një natë në muajin **qershor të vitit 1998**, një grup i personave të maskuar e ka rrëmbyer Igballen nga shtëpia dhe e ka çuar në drejtim të panjohur. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e shihnin të gjallë. E bija Sebahatja ishte pjesëtare e UÇK-së. Në **gusht të vitit 1998**, Sebahatja doli nga shtëpia dhe nuk u kthye kurrë më. Në **tetor të vitit 1998**, një grup i maskuar sërish ka ardhur te shtëpia e familjes